



Republika e Kosovës - Republic of Kosovo  
Komuna – Municipality  
Hani i Elezit



05/ 1704 / 2025  
Data 18.02.2025

Në bazë të Rregullorës për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.01/8214/2024 të datës 04.10.2024 neni 14 pika 14.1.1 dhe neni 15, Drejtoria Komunale për Arsim bën këtë:

**THIRRJE PUBLIKE**  
**PËR NDARJEN E BURSIVE PËR STUDENT/E TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT**

**Kushtet për aplikim;**

- Të jenë banorë të Komunës së Hanit të Elezit;
- Të jenë student/e të Universitetit Publik të Kosovës;
- Të jenë student/e të Universitetit Publik të Maqedonisë Veriore;
- Të jenë student/e të rregullt, por jo me vetëfinancim;
- Të kenë të regjistruar vitin;
- Studenti/ja nëse një herë ka përsëritur vitin, humbë të drejtën e bursës (vlenë për gjitha vitet);
- Studenti/ja i cili ka qenë përfitues i bursës në një fakultet, nuk mund të jetë përfitues i bursës për fakultetin e dytë;
- Studenti/ja nëse e ka një fakultet të përfunduar, nuk ka të drejt aplikimi për bursë;

**Prioritetet për kuadro deficitare janë Fakultetet:**

- Fakulteti i Mjekësisë** (Mjekësi e Përgjithshme, stomatologji, farmaci).  
**Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës** (Konstruksioneve, Hidroteknikës, Gjeodezisë, Inxhinierisë së Ambientit, Arkitekturë dhe Eficiencë e Energjisë).
- Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike** (Inxhinieri Kompjuterike, Telekomunikacion, Elektronikë, Automatikë, Sistemet Elektroenergjetike, Elektroenergjetikë Industriale).
- Fakulteti i Edukimit** (Matematikë, Fizikë, Kimi, Biologji dhe Teknologji me TIK)
- Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike** (Prodhimtari dhe Automatizim, Termoenergjetikë dhe termoteknikë, Konstruksione dhe mekanizim, Komunikacion).
- Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë** (Veterinari, Agroekonomi, Bioteknologji, Lavërtari – Perimtari, Mbrojtje e Bimëve, Pemëtari – Vreshtari, Bioteknologji Ushqimore).  
**Fakulteti i Xehetarisë dhe Metalurgjisë** (Xehetarisë, Gjeologjisë, Materiale dhe Metalurgji, Teknologjisë).
- Fakulteti i Shkencave Matematikë – Natyrore** (Matematikë, Fizikë, Kimi, Biologji, Shkenca Kompjuterike)
- Fakulteti i Arteve**
- Fakulteti Filologjik** (Gjuha Angleze, Gjuha Gjermane).

### Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- a) Çertifikata e notave (me vulë origjinale)
- b) Vërtetimi i semestrit se studenti ka regjistruar vitin akademik 2024/2025 (me vulë origjinale);
- c) Fotokopje ID apo indeksin (fotografin, semestrat dhe notat);
- d) Deklarata e bashkësisë familjare;
- e) Çertifikatën e vendbanimit;
- f) Dëshmia se është; invalid i luftës, fëmijë i dëshmorit, veteranit të luftës, martirit të luftës, person me aftësi të kufizuara, familja në skemën sociale;
- g) Studentë që janë invalid të luftës, anëtarë të familjes së dëshmorit, invalidit të luftës, veteranit të luftës, martirët e luftës, me gjendje të rëndë sociale, student me aftësi të kufizuara duhet të sjellin dëshmitë nga shoqatat libreza dhe institucionet përkatëse;
- h) Diplomat, mirënjohjet, çertifikatat për suksesin e arritur në gara-kurse kombëtare dhe ndërkombëtare në lëmin e arsimit;
- i) Studentët e vitit të parë u merret nota mesatare e suksesit të shkollës së mesme të lartë numri i pikëve të testit të arritshmërisë dhe provimet e dhëna në fakultetin përkatës;
- j) Kopjen e letërnjoftimit dhe
- k) Vërtetim mbi llogarinë bankare (origjinale);

### Afati dhe mënyra e aplikimit:

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve bëhet në Qendrën për Shërbim të Qytetarëve të Komunës së Hanit të Elezit (kati i parë) nga ora 08:00-16:00 çdo ditë pune.  
Afati për aplikim është **15 ditë** prej datës **19.02.2025** deri më datën **05.03.2025**

**Sqarim shtesë:** Për bursë kanë **prioritet studentet e vitit të dytë e më lartë**, në rast se nuk plotësohet numri i studentëve që plotësojnë kriteret sipas rregullores Nr. 01/ 8214/ 2024 do të plotësohet me studentët e vitit të parë sipas **Nenit 15 pika 15.1.9.**

**Sqarim shtesë:** në rast se nuk plotësohet me studentet nga Maqedonia Veriore me lëndë deficitare do të plotësohen me studentët nga R. e Kosovës me prioritet për kuadro deficitare, apo e kundërta.

**Vërejtje:** Nëse në dosjen e aplikuesit mungon një dokument apo nuk përputhen të dhënat e kërkuara sipas kriterëve të thirrjes, aplikacioni nuk do të shqyrtohet nga ana e komisionit.

Drejtori i DKA-së  
Hisni Luri

